

BEQIR META**MARRËDHËNIET SHQIPTARO-GREKE PAS VENDIMIT
TË GJYKATËS SË HAGËS PËR ÇËSHTJEN
E SHKOLLAVE MINORITARE
(prill-gusht 1935)****Jehona e vendimit të Gjykatës së Hagës**

Në vitet 1934-1935 Greqia dhe Shqipëria u angazhuan në një debat të fortë për çështjen e shkollave greke në zonën e minoritetit. Qeveria shqiptare vendosi shtetëzimin e këtyre shkollave pa ndryshuar programin mësimor dhe tekstet e tyre. Qeveria greke dhe minoritetit grek e kundërshtuan këtë masë dhe kërkuan që të ruheshin shkollat private, të cilat financoheshin në mënyrë të fshehtë nga qeveria greke dhe organizatat vorio-epirote. Çështja u diskutua nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve i cili ia përcolli atë për shqyrtim Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë.

Përfundimi juridik i debatit për shkollat private në Shqipëri u arrit më 6 prill 1935, me vendimin e Gjyqit të Hagës, shumica e të cilit (përfaqësuesit e Italisë dhe të shtatë shteteve të tjera) u shprehën kundër pikëpamjes së qeverisë shqiptare për të drejtën që kishte shteti shqiptar për të shtetëzuar shkollat fillore brenda vendit, i cili ishte një masë me karakter të përgjithshëm që shtrihej mbi të gjithë sistemin arsimor.

Gjykata e Hagës i dha një interpretim juridik Deklaratës së Nolit në Lidhjen e Kombeve më 2 tetor 1921, i cili ishte në kundërshtim me të gjitha dispozitat kushtetuese ose ligjore që ishin zbatuar për shkollat private të shumicës etnike të popullit shqiptar.

Më 7 prill 1935, Radio Roma dha lajmin se Gjykata e Hagës kishte vendosur në disfavor të Shqipërisë me 8 vota pro vendimit dhe 3 kundër tij. Ky lajm u përhap shpejt midis popullsisë grekofone dhe shkaktoi një entuziazëm të madh.

Në ditët e para të prillit 1935, shtypi grek njoftoi se Gjykata e Hagës e pranoi plotësisht pikëpamjen dhe interpretimin grek se minoriteti grek duhej të emëronte vetë mësuesit që i pëlqenin, ndërsa më parë Lidhja e Kombeve e kishte detyruar qeverinë shqiptare që gjithë lënda mësimore në këto shkolla të mësohej në gjuhën greke. Këtë vendim ajo e cilësoonte

si fundin e përpjekjeve që kishte bërë vitet e fundit qeveria shqiptare "për të shqiptarizuar" minoritetin grek¹.

Shtypi shqiptar reagoi me maturi dhe pa teprime nacionaliste ndaj vendimit të Gjykatës së Hagës. Ai vuri në dukje se kjo Gjykatë e shqyrtoi çështjen vetëm nga ana juridike. U evidentua fakti se tre juristë të mëdhenj dhe me famë ndërkombëtare ishin shfaqur kundër vendimit të shumicës së Gjykatës. Gazeta "Demokratia" e kritikonte vendimin e Hagës, duke iu referuar edhe fletores së njohur franceze "Journal des Débats", e cila kishte shkruar se "argumentet juridike kishin vlerën e tyre sepse shkruheshin në tekste, por edhe shpirti i tekstit duhej të mbizotëronte. Gjithashtu edhe arsyet politike duheshin marrë në konsideratë të plotë, sidomos kur bëhej fjalë për të ruajtur unitetin kombëtar të një kombi të ri".²

Në shtyp shfaqej zhgënjimi se Lidhja e Kombeve nuk e kishte marrë parasysh argumentin politik dhe nevojën e bashkimit politik të shqiptarëve. Por ende ruhej shpresa se Lidhja e Kombeve "nuk do ta pranojë kurrë që një shtet i huaj, me pretekstin e mbrojtjes, të interesohej drejtpërdrejt për pakicat, duke shembur kështu themelet e shtetit ku ndodheshin këto pakica". Jo vetëm pse Shqipëria, si një shtet i vogël dhe i ri, kishte nevojë për konsolidimin dhe bashkimin kombëtar por edhe sepse një vendim i kundërt eventual i Lidhjes së Kombeve do të krijonte një shtet brenda shtetit për shumë vende që kishin pakica, të cilat, siç e kishte thënë dikur diplomati francez Briandi, do të përbënin një rrezik³.

Gazeta e lartpërmendur shkruante se duhej marrë parasysh fakti se gjendja e pakicave grekofone ishte krejt e ndryshme nga ajo e pakicave të shteteve të tjera. "Shqipëria është i vetmi shtet në botë që mund të tregohet si shembull për respektimin më të plotë të drejtave të pakicës. Me përjashtim të emrit "minoritet", pakica grekofone në Shqipëri nuk ka as më të voglin ndryshim nga ne shqiptarët, gëzon tërë të drejtat dhe ka marrë e po merr pjesë në të gjitha aktivitetet shoqërore dhe politike të vendit, njëlloj me të gjithë shtetasit e tjerë."

Pretendimi i grekëve për çeljen e shkollave private cilësohej i pavend, "sidomos kur dihej prej të gjithëve se ato shkolla subvencionoheshin nga

¹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), viti (më tej: V.) 1935, dosja (më tej: D.) 183, fl.12. Përkthim i artikullit të gazetës greke *Vradhini*, 7 prill 1935.

² *Demokratia*, "Shkollat grekofone", 26 maj 1935.

³ *Po aty*.

një shtet i huaj". Gjithashtu njohja e një të drejte të tillë për pakicat grekofone, jo vetëm do të ndërronte krejt faqen e organizimit arsimor të Shqipërisë por, nga ana juridike, do të ishte e padrejtë, pasi këtë të drejtë nuk e gëzonte shumica e natyrisht s'mund ta kishte as pakica. Gazeta kritikonte grekofonët të cilët kishin një vit që i kishin lënë fëmijët e tyre pa shkollë dhe, kështu, po bëheshin, "ndofta pa dashur, vegël e një politike të gabuar të një shteti të huaj që shtyhet t'i bëjë këto veprime, mbase, për hatër të partive ose për qëllime të tjera". Atyre u bëhej thirrje të hiqnin dorë nga bojkoti i shkollave⁴.

Kujdesi, moderacioni dhe shmangia e emocioneve dhe e veprimeve nacionaliste vihej re edhe në qëndrimet e qeverisë. Kështu, Ministria e Brendshme ndaloi një protestë të patriotëve korçarë kundër vendimeve të Gjykatës së Hagës. Organizatorët e saj u falënderuan dhe atyre iu tha se, hë për hë, nuk ishte nevoja të bëhej protestë⁵.

Gjykata e Hagës e bëri publik vendimin e saj nëpërmjet një deklarate për shtyp në të cilën pohohej se çështja e shkollave ishte një çështje barazie midis shumicës dhe pakicës dhe se barazia faktike e së drejtës i kundërvihet një barazie të pastër formale dhe mund të bënte të nevojshme trajtime të ndryshme të destinuara për të vendosur një ekuilibër në situata të ndryshme. Barazia e trajtimit të shumicës dhe pakicës do të ndërpritej nëse këto institucione do të zëvendësoheshin nga institucione të shtetit⁶.

Vendimit të Gjykatës së Hagës i bëri jehonë edhe shtypi evropian, si gazetat "Times" dhe "Near East" e Londrës⁷.

Legata shqiptare e Londrës bënte këto komente lidhur me këtë vendim⁸: Ajo pohonte se, meqë mendimi ishte dhënë me shumicë zërash, dëmi që i ishte shkaktuar prestigjit të shtetit shqiptar ishte më i lehtë. Nëse Gjykata do të kishte vendosur me unanimitet do të kishte qenë shumë më e papëlqyeshme për Shqipërinë dhe vendimi do të kishte paragjykuar gjendjen dhe politikën e saj. Ajo pohonte se, meqë konflikti nuk u përfundua me marrëveshje midis dy qeverive ose nga Këshilli i LK,

⁴ *Po aty.*

⁵ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: *F.*), MPB, viti (më tej: *V.*) 1935, dosja (më tej: *D.*) 399, fl.152. MPB - Prefekturës së Korçës, 25 maj 1935.

⁶ *AMPJ*, V. 1935, D. 297, fl.381-383, Dr. Otto Ronart, Communiqué No.868 (non-official), La Haye, le 6 avril 1935.

⁷ *Po aty*, D. 297, fl. 270, Legata shqiptare Londër – MPJ, 11 prill 1935.

⁸ *Po aty.*

por çështja iu referua Gjykatës së Hagës, shanset për një përfundim në favorin e Shqipërisë kishin qenë të pakta, sepse nga pikëpamja teknike juridike, qëndrimi i qeverisë shqiptare nuk mbrohej shumë lehtë.

Por, meqë tre nga juristët e shquar të Gjykatës së Hagës i dhanë mbështetje tezës shqiptare, “nderi ishte shpëtuar” dhe ajo mund të qëndronte krenare pasi Këshillit dhe Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve mund t’i përgjigjej ballëhapur se masa e saj nuk kishte qenë një vepër arbitrare por, përkundrazi, ajo kishte pasur mbështetje shumë të fortë në parimet juridike, sikundër u konfirmua edhe nga përkrahja që i dha pakica e Gjykatës së Hagës.

Ministri i Shqipërisë në Londër shprehte shpresën se, meqë mendimi konsultativ ishte dhënë me shumicë votash dhe jo me unanimitet, Këshilli i LK do të sugjeronte dhe këshillonte një kompromis dhe një zgjidhje të drejtpërdrejtë. Në qoftë se nuk do të veprohej në këtë mënyrë, Këshilli mund të kërkonte zbatimin me përpikmëri të Deklaratës së vitit 1921. Në këtë rast qeveria shqiptare do të kishte të drejtë të ushtronte një kontroll të fortë mbi administrimin e shkollave grekofone. Do të kontrollohej imtësisht se si dhe nga çfarë burimesh paguheshin mësuesit e shkollave minoritare. Këto pikëpamje të ministrit shqiptar i kishin përkrahur edhe disa nga diplomatët që ai kishte takuar në Londër dhe veçanërisht E. Colban-ish drejtor i Minoriteteve në Lidhjen e Kombeve, i cili aktualisht ishte ministër i Norvegjisë në Londër. Ai kishte shfaqur mendimin se Vendimi i Hagës nuk ishte krejtësisht i pafavorshëm për Shqipërinë.

Colban kishte sugjeruar që, në të njëjtën kohë, duhej nxitur pakica shqiptare në Greqi të kërkonte të drejta analoge për hapjen e shkollave shqipe. Ai shprehej se, deri atëherë, elementi grekofon në Shqipëri nuk kishte pasur asnjë diskriminim. Mirëpo, duke pasur parasysh se shqiptarët në Greqi nuk gëzonin asnjë të drejtë, “mundej që këtej e tutje t’i jepej preferencë elementit shqiptar”, në raport me elementin grekofon. Por ai gjithashtu paralajmëronte se “një politikë e tillë mund të sjellë ndërlikime dhe duhej peshuar fort hollë”, pasi “prestigji i shtetit dëmtohet pa masë, nëse më vonë ai mund të detyrohet të tërhiqej”. Ai konsideronte si më të dobishme “ndjekjen e një politike, e cila do të na shquante si shtetin ku minoritetet kanë trajtimin më të pëlqyer dhe më të kënaqshëm”⁹.

Gjithsesi, vendimi i Gjykatës së Hagës ishte tronditës për autoritetet shqiptare të cilët tani filluan të shqetësohen seriozisht se do të viheshin në

⁹ *Po aty.*

pikëpyetje sovraniteti i vendit dhe vetë institucionet kombëtare shqiptare për të cilat ishte investuar aq shumë dhe ishin bërë sakrifica e përpjekje të mëdha nga shteti e nga shoqëria shqiptare. Prefektura e Gjirokastrës kishte informata se tashmë mund të fillonte edhe propaganda për ndarjen e grekofonëve nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë dhe mund të mbylleshin edhe kishat derisa ata t'ia arrinin qëllimit¹⁰. Edhe prefektura e Korçës informonte se, pas vendimit të Hagës, në Korçë kishte filluar një propagandë në formë përshpirtjesh për të kërkuar nga qeveria hapjen e shkollave fetare ortodokse. Kjo propagandë e fshehtë e kishte burimin në Mitropolinë e atjeshme¹¹.

Vendimi i Hagës shkaktoi hidhërim në të gjithë inteligjencën dhe opinionin atdhetar shqiptar¹².

E ndodhur nën këtë trysni, qeveria u përpoq të merrte disa masa për të qetësuar situatën. Ajo urdhëroi prefekturën e Korçës që të bllokonte shpërndarjen e atyre fletoreve që përmbanin komente të dëmshme për interesat e shtetit shqiptar¹³.

Por, nga ana tjetër qeveria, për herë të parë, filloi të studionte mundësinë e një kundërveprimi ndaj disfatës që kishte pësuar. Në të njëjtën kohë ajo udhëzoi prefekturën e Gjirokastrës që të bënte hetime të imta e shumë të fshehta se cili nga pronarët shqiptarë kishte në tokat e veta bujq grekofonë¹⁴.

Konsullata greke nxitoi të merrte masat për të thyer çdo rezistencë të mundshme të qeverisë shqiptare. Ajo urdhëroi agjentët e saj të nxisnin popullin t'i hapte vetë shkollat private, në qoftë se qeveria shqiptare nuk do t'i lejonte, sepse tashmë, pas Vendimit të Lidhjes së Kombeve, qeveria shqiptare nuk mund të merrte asnjë masë kundër interesave të grekofonëve¹⁵. Konsulli grek u dha shpresë disa ish mësuesve të shkollave private se së shpejti qeveria shqiptare do të hynte në marrëveshje me qeverinë greke për çështjen e shkollave. Në qoftë se nuk do të arrihej ndonjë marrëveshje, atëherë duhej bërë një demonstratë me

¹⁰ *AQSH*, F. MPB, V. 1935, D. 399, fl.69. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 9 prill 1935.

¹¹ *Po aty*, fl.116. Prefektura e Korçës - MPB, 26 prill 1935.

¹² *Po aty*, fl.73. Prefektura e Shkodrës - MPB, 11 prill 1935.

¹³ *Po aty*, fl.78. MPB - Prefekturës Korçë, 13 prill 1935.

¹⁴ *Po aty*, fl.114. MPB - Prefekturës Gjirokastrë, 27 prill 1935.

¹⁵ *Po aty*, fl.126. Prefektura Gjirokastrë - MPB, 11 maj 1935.

qëllim që të turbullohej qetësia dhe të detyrohej qeveria shqiptare të çelte shkollat.

Nëse gjendja do të përkeqësohej, si rezultat i kundërshtimeve të Tiranës për të hapur shkollat private minoritare, autoritetet greke kishin parashikuar të shkonin më tej dhe t'i jepnin dimensione të reja lëvizjes separatiste të minoritetit grek, duke mos harruar objektivin e vjetër nacionalist kundrejt Shqipërisë së Jugut. Në se do të krijoheshin rrethanat e përshtatshme, lëvizja separatiste parashikohej të shtrihej edhe në krahinat me popullsi ortodokse shqiptare. Fillimisht, në shenjë presioni, do të mbylleshin edhe kishat në zonën e minoritetit. Konsulli grek dha porosi që grekofonët të mos nënshkruanin ndonjë deklaratë që do t'u propozohej nga ana e qeverisë shqiptare. Organet e Konsullatës po përhapnin fjalë në katundet e Dropullit se, pas fitores në çështjen e shkollave, do të bëhej edhe ndarja e kishës. Bashkë me këtë do të ligjëroheshin sërish martesat fetare dhe përdorimi i gjuhës greke do të ishte i lirë në zyrat komunale¹⁶.

Disa nacionalistë grekë, të ekzaltuar nga fitorja e arritur, nxitën popullsinë minoritare që të merrte pjesë edhe në zgjedhjet për Asamblenë Greke. Ata porositën që çdo katund t'i dorëzonte Konsullatës greke votat e veta të mbyllura në një zarf. Mirëpo konsulli grek e ndaloi këtë votim deri në marrjen e një urdhri të dytë¹⁷.

Për të frenuar veprimet e mëtejshme ekstremiste të grekofonëve, prefektura e Gjirokastrës sugjeroi që të thirreshin nëpunësit e lartë grekofonë të cilëve t'u thuhej se ata mund të humbnin nëpunësinë në rast se situata përkeqësohej. Gjithashtu, pikë së pari, në Fushën e Dropullit, ku elementi grekofon ishte shumë fanatik dhe propaganda greke e fuqishme, të instaloheshin emigrantë nga Kosova në tokat shtetërore dhe në çifligjet private të pronarëve shqiptarë. Kështu, situata do të ndryshonte menjëherë. Por, meqë e kuptonte se këto masa ishin delikate, ajo sugjeronte që ato të studioheshin mirë. Në fakt, ky propozim, ndonëse kishte karakter nacionalist dhe synonte që të ushtrohej presion ndaj minoritetit grek, nuk kishte të krahasuar me padrejtësitë që u kishte bërë shteti grek shqiptarëve të Greqisë. Ai i kishte dëbuar ata, duke u grabitur pronat e tyre, ndërsa prefektura e Gjirokastrës sugjeronte vendosjen e

¹⁶ *Po aty*, fl.103. Prefektura Gjirokastrë - MPB, 24 prill 1935.

¹⁷ *Po aty*, fl.129. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 14 maj 1935.

bujqve shqiptarë në çifligjet shtetërore dhe private të pronarëve shqiptarë dhe jo shpronësimin e pronave tokësore të popullsisë minoritare.

Megjithëkëtë, ky propozim i prefekturës, jo vetëm që ishte i pazbatueshëm por, siç do ta shohim më tej, ai i shkaktoi një telash tjetër të madh qeverisë dhe Mbretit Zog, pasi ai ra në vesh të përfaqësuesve britanikë, të cilët ushtruan një presion të fortë mbi Mbretin dhe qeverinë për të shpjeguar se cila ishte e vërteta e këtij plani.

Në të njëjtën kohë prefektura kishte përpara edhe një problem tjetër delikat për të zgjidhur. Ajo nuk kishte rënë dakord me Inspektorin e Oborrit Mbretëror, Haxhi Shkozën mbi mënyrën e rregullimit të konflikteve që ekzistonin midis privatëve dhe pasurisë mbretërore në Sarandë, pasi e konsideronte propozimin e tij kundër interesave të shtetit dhe të Mbretit. Shqetësimi i autoriteteve vendore ishte i madh sepse, po të aplikohesh sistemi i propozuar prej tij, do ta kthente Sarandën në një qytet krejtësisht grekofon, si një lagje e Korfuzit¹⁸.

Situata e krijuar shkaktoi në Shqipëri pakënaqësi kundër Vendimit të Gjyqit të Hagës. Qarqe patriotike shqiptare, myslimane e të krishtera, të tronditura nga Vendimi i Gjyqit të Hagës, po përpiqeshin të organizonin një protestë kundër tij. Nismëtarët kryesorë të kësaj proteste në Korçë ishin Kristo Kirka e Tefik Panariti. Kjo lëvizje synonte që t'u pritej hovi disa intrigave fetare dhe aktivitetit të disa elementëve, të cilët, megjithëse ishin të parëndësishëm, po përpiqeshin të turbullonin qetësinë në Korçë¹⁹.

Edhe Ministria e Arsimit mbeti e befasuar nga Vendimi i Hagës. Në një raport të gjatë drejtuar Kryeministrit, ajo vinte në dukje motivet dhe historinë e procesit të shtetëzimit të shkollave të minoriteteve²⁰.

Ajo sqaronte se mbyllja e të gjitha shkollave private në Shqipëri ishte bërë në zbatim të neneve 206 e 207 të Statutit Themeltar të Mbretërisë, i votuar prej Parlamentit në prill të vitit 1933. Mbyllja e shkollave private ishte bërë gjatë periudhës prill-shtator 1933. Në kohën e shtetëzimit të shkollave private nuk kishte ekzistuar asnjë shkollë private e pakicës greke. Ato ishin zhdukur me kohë, dalëngadalë nga indiferenca e popullsisë grekofone e cila, mesa duket, nuk kishte qenë në gjendje të paguante mësuesit privatë, ashtu edhe prej mungesës së personelit me

¹⁸ *Po aty*, fl.110-111. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 26 maj 1935.

¹⁹ *AMPJ*, V. 1935, D. 399, fl.151. Prefektura Korçë - MPB, 21 maj 1935.

²⁰ *AQSH*, Fondi Kryeministria, V.1935, D. IV-391, fl.15. Raport i MA, dërguar Kryeministrit.

cilësitë që kërkonin ligjet në fuqi. Ministria e Arsimit ishte kujdesur që të hapeshin shkolla shtetërore me mësues të përshtatshëm. Kështu, në prill të vitit 1933 nuk ekzistonte asnjë shkollë private greke, por vetëm 10 mësues privatë, të cilët punonin bashkë me mësuesit zyrtarë në 10 shkolla shtetërore në 10 katunde grekofone. Në shtator të vitit 1933, kur u zbatua ndryshimi i Statutit, këta 10 mësues privatë u ndaluan nga veprimi.

Ministria e Arsimit e konsideronte Deklaratën e 2 tetorit 1921 një angazhim unilateral. Ajo e kishte interpretuar atë, duke u bazuar në nenin 1 dhe në shpirtin e gjithë përmbajtjes së saj, si një angazhim të Shqipërisë që minoritetet e saj të mos pësonin nën regjimin shqiptar ndonjë cenim të drejtave të tyre politike e civile, si edhe për përdorimin e lirë të gjuhës në marrëdhënie të ndryshme e në shkolla, duke theksuar gjithnjë barazinë në këto të drejta, të pakicës me ato të shumicës etnike. Kështu, nuk mund të pranohej kurrsesi që qëllimi i Deklaratës kishte qenë t'i jepte pakicës një të drejtë dhe një privilegj që i ishte mohuar shumicës. Ministria e Arsimit vinte në dukje se përcaktimet e bëra në Deklaratën e vitit 1921 ishin bërë duke marrë parasysh faktin se parimi i shkollave private në atë kohë ishte i pranuar në të gjitha shtetet dhe, në anën tjetër, kishte dashur t'i siguronte pakicës mësimin e gjuhës, po me mjetet e përdorura nga shumica. Për këtë qëllim, si edhe kundër çdo mosinteresimi eventual të shtetit, në Deklaratë ishte thënë se pakica kishte të drejtën e barabartë me shumicën etnike për të mbajtur shkolla me shpenzimet e veta, domethënë shkolla private. Në këtë mënyrë, fjalët "shkolla me shpenzimet e veta" nuk ishin qëllim në vetvete, por një mjet i vënë në dispozicion të pakicës për të realizuar një të drejtë të njohur.

Ministria e Arsimit pohonte se ajo, duke u frymëzuar prej parimit më elementar të së drejtës konstitucionale, sipas të cilit të gjithë shtetasit janë të njëjtë përpara Statutit e ligjeve në fuqi, duke pasur parasysh shpirtin e Deklaratës së 2 tetorit, sipas së cilës një e drejtë është e tillë për pakicën nëse është e drejtë për shumicën etnike dhe, duke pasur parasysh në këtë rast konkret, dispozitën e qartë të nenit 5 të Deklaratës, sipas të cilit, e drejta e mbajtjes së shkollave private nga ana e pakicës i nënshtrohet konditës "droit égal" me shumicën etnike, kishte menduar se ndryshimi i nenit 207 të Statutit të Mbretërisë duhej zbatuar për të gjitha shkollat private të shumicës etnike të mbajtura nga shqiptarët ose të huajt, ashtu edhe për shkollat private të pakicës, duke menduar se angazhimi i marrë prej shtetit shqiptar më 2 tetor 1921 për shkollat private të pakicës nuk prekej me mbylljen e tyre.

Duke marrë këtë masë që lidhej vetëm me natyrën e mësimit dhe ruajtjes së gjuhës së pakicave, Ministria e Arsimit pohonte se nuk kishte shkelur aspak angazhimin e marrë nga shteti për sa i përkiste të drejtës esenciale që u ishte siguruar pakicave në Deklaratën e vitit 1921. Dhe, ashtu si shumicës etnike, i ishte siguruar mësimi i gjuhës vetëm në shkollat zyrtare të shtetit, kështu edhe pakicave u ishte siguruar, po nëpërmjet shkollave zyrtare e shtetërore, legalisht e plotësisht, zhvillimi i mësimit në të gjitha klasat e në të gjitha lëndët në gjuhën e tyre amtare.

Duke bërë këtë zgjidhje, pakicave serbe e vllahe iu ruajt ai numër shkollash që kishin pasur më parë, ndërsa për pakicën grekophone, Ministria e Arsimit hapi një numër shkollash që zhvillonin mësimin tërësisht në gjuhën greke, më të madh se sa kishte qenë më parë dhe në proporcion më të lartë se sa u takonte atyre po të zbatoheshin neni 6 i Deklaratës së vitit 1921, i cili përcaktonte raportin e barabartë të shkollave shtetërore të shumicës dhe të pakicave. Këtë e provonte edhe statistika e mëposhtme²¹:

	Shqiptarë	Grekofonë
1. Popullsia (regjistrimi i vitit 1930)	965 573	37 217
2. Fëmijë në moshën e detyrimit për shkollat fillore	125 000	4 652
3. Popullsia që kishte shkollë	363 424	29 929
4. Nxënës që ndjekin shkollën	45 378	3 692
5. Përqindja e nxënësve që frekuentonin shkollën në raport me fëmijët në moshën e detyrimit shkollor	36,29%	79,30%
6. Përqindja e nxënësve në popullsinë e përgjithshme	4,8%	9,9%

Ministria e Arsimit vinte në dukje se pakica serbe, me një shkollë dhe pakica vllahe, me dy shkolla, ishin kënaqur me këtë zgjidhje, e cila u siguronte mësimin e gjuhës amtare, jo më pak se në shkollat private dhe, në anën tjetër, i shkarkonte këta komunitete nga barra e rëndë financiare. Kurse pakica grekophone, e cila në momentin e shtetëzimit nuk kishte asnjë shkollë private, por vetëm 10 mësues privatë në shkollat zyrtare, nuk u kënaq, megjithëse ajo ishte më e varfër se sa dy pakicat e tjera të lartpërmendura. Ministria e Arsimit e përfundonte parashtrësën e saj duke theksuar se grekofonët iu drejtuan Lidhjes së Kombeve, jo për arsyen se u ishte shkelur e drejta e mësimit të gjuhës, por për arsye të tjera politike.

²¹ Po aty.

Përpyjekjet për arritjen e një marrëveshjeje pas Vendimit të Hagës

Në momentet e para pas Vendimit të Hagës, qeveria shqiptare nuk e kishte përcaktuar qëndrimin që do të mbante ndaj shkollave greke. Ministria e Jashtme udhëzoi Legatën në Athinë që, në bisedimet me palën greke, duhej të përfitonte nga ankesa e popullsisë çame në Gjenevë lidhur me mohimin e të drejtave nga qeveria greke dhe nga kërkesa që ajo kishte bërë për të çelur shkolla shqipe. Përfaqësia shqiptare duhej të përpiqej "të krijonte një farë lidhje midis këtyre dy çështjeve shkollore, pa theksuar kurrë mbi qëndrimin e qeverisë shqiptare rreth shkollave greke"²².

Në këtë kohë, në Gjenevë, u emërua si delegat i Greqisë Rosetti - ish drejtor politik i MPJ të Greqisë, i cili kishte demonstruar më parë tendenca për kompromis. Ministria e Jashtme e Shqipërisë e udhëzoi përfaqësuesin e saj në Gjenevë të kontaktonte me të "në mënyrë akademike" dhe "t'i tregonte nevojën e domosdoshme për një marrëveshje të drejtpërdrejtë midis dy shteteve fqinj"²³. Rosetit do t'i vihej në dukje se, "qëllimi nuk ishte konfirmimi i vlerës juridike të Deklaratës së vitit 1921 por vënia në zbatim e saj me një shpirt dashamirësie, gjë që sigurohej vetëm me një "bonne compréhension reciproque" (mirëkuptim reciprok).

Përfaqësuesi shqiptar do të propozonte një marrëveshje me këtë përmbajtje:

1. Pleqësitë e katundeve grekofone do të kishin të drejtë të shënonin mësuesit drejtpërdrejtë, listën e tyre do t'ia dorëzonin Inspektorit të Arsimit në Gjirokastër, i cili do t'ia paraqiste këtë listë Ministrisë së Arsimit. Kështu emërimi i tyre merrte fund përfundimisht. E drejta e caktimit të mësuesve nga pleqësitë do të ishte e përhershme. Në çdo rast kur do të krijohet një vend vakant do të ndiqej e njëjta procedurë për plotësimin e tij.

2. Ministria e Arsimit do të paguante drejtpërdrejt këto mësues. Pagesa nga ana e minoritetit grekofon ishte e papranueshme sepse tashmë dihej që fondet vinin nga Greqia. Shteti shqiptar kishte të drejtë t'u kërkonte katundeve vërtetimin e burimeve të këtyre të hollave.

²² *AMPJ*, V. 1935, D.297, fl.269. Ministri i Jashtëm Xh. Vila - Legatës në Athinë, 10 prill 1935.

²³ *Po aty*, fl.276-277, MPJ - Lec Kurtit, 17 prill 1935.

3. Qeveria shqiptare ishte e gatshme të çelte 50 shkolla për popullsinë grekofone me mësues të emëruar sikurse u tha më lart.

4. Pleqësia e katundeve do të kishte të drejtë të zgjidhte 5-7 nxënës nga nxënësit e klasave të fundit që kishin marrë notat më të mira, të cilët Ministria e Arsimit do t'i dërgonte me fondet e saj në shkollat greke për t'u bërë mësues. Pleqësitë e katundeve do t'i caktonin mësuesit në të ardhmen midis këtyre bursistëve të diplomuar në shkollat greke.

Përfaqësuesi shqiptar u udhëzua që të bindte Rosettin se çështjet në të cilat kishte këmbëngulur qeveria greke, si e drejta e popullsisë grekofone për të caktuar mësuesit si dhe dërgimi i nxënësve grekofonë për studime në Greqi si bursistë, sigurohej plotësisht me propozimet e lartpërmendura.

Qeveria shqiptare angazhohej që, në bazë të kësaj marrëveshje, të çelte shkolla greke. Kështu ajo nuk i largohej shpirtit të Deklaratës së vitit 1921. Por nga ana tjetër ajo këmbëngulte që edhe qeveria greke të aplikonte menjëherë traktatin e minoriteteve në favor të popullsisë çame me këto kushte:

a. Në katundet shqiptare të Çamërisë, ku ekzistonin shkolla greke, do të çelleshin kurse në gjuhën shqipe me mësues që kishin mbaruar mësimet në Shqipëri por që ishin nënshkretës grekë.

b. Në ato katunde shqiptare ku nuk kishte shkolla greke, qeveria greke duhej të zotohej që do të çelte shkolla shqipe.

c. Qeveria greke do të dërgonte në Shqipëri, çdo vit me fondet e saj, 7 djem të çmuar si bursistë për të frekuentuar shkollat shqipe. Këto bursistë do të ishin të destinuar të bëheshin mësues në shkollat e Çamërisë.

Propozimet e qeverisë shqiptare ishin serioze dhe ndihmonin për të zgjidhur mosmarrëveshjet lidhur me trajtimin e pakicave si dhe për krijimin e një klime miqësore midis dy vendeve. Me këto propozime pala shqiptare bënte lëshime të rëndësishme pasi të drejtat e shkollimit që ajo propozonte për minoritetin shqiptar në Greqi, ishin shumë më të kufizuara se ata që ajo i njihte minoritetit grekofon. Por megjithëkëtë qeveria greke nuk e pëlqente një marrëveshje të tillë e cila, edhe pse kishte kufizimet e lartpërmendura për pakicën shqiptare, ishte hartuar mbi bazën e parimit të reciprocitetit. Pak kohë para se të shkonte në Gjenevë, Rosetti kishte marrë një qëndrim më mospajtues. Ai i kishte deklaruar Sekretarit të Legatës shqiptare në Athinë se qeveria greke nuk dëshironte, në asnjë mënyrë, që as forma, dhe as kuptimi i Deklaratës së vitit 1921 të modifikoheshin nga ana e qeverisë shqiptare. Kjo deklaratë e Rosettit ishte në kundërshtim me deklaratën që kishte bërë në

parlamentin grek ministri i Jashtëm i Greqisë, Maximos, në fillim të konfliktit i cili kishte thënë se "qeveria greke do të jetë e lumtur të shohë adoptimin e një formule transactionnelle" (të ndërmjetme).

Kjo deklaratë e Maximosit do të përdorej si argument në bisedimet me Rosettin për të mbështetur pikëpamjen shqiptare. Gjithashtu L. Kurti udhëzohej që të përdorte për këtë qëllim edhe faktin se ministri rumun në Shqipëri kishte pranuar pikëpamjen e qeverisë shqiptare, që paria e komunitetit të shënonte mësuesit, të cilët Ministria e Arsimit do t'i emëronte definitivisht. Këto mësues, që deri në atë kohë ishin paguar nga ana e komunitetit arumun, tashmë do të paguheshin nga Ministria e Arsimit. Gjithashtu, po për këtë qëllim, Rosettit do t'i përmendeshin edhe konsideratat që kishte shfaqur Legata Shqiptare e Londrës lidhur me Vendimin e Gjykatës së Hagës²⁴.

Përpjekjet diplomatike të qeverisë shqiptare për të zbutur efektet e Vendimit të Hagës

Qeveria shqiptare u përpoq ta amortizonte goditjen që mori nga Gjyqi i Hagës. Pikërisht ky qëndrim vihej re edhe në udhëzimet që ajo i dha disa ditë më vonë përfaqësuesit të saj në Gjenevë, Lec Kurtit²⁵. Ajo nënvizonte faktin se, ndër anëtarët e Gjykatës që kishin mbështetur tezën shqiptare, kishte qenë edhe kryetari i saj, anglezi Cecil Hurst, i cili "gëzonte një famë të përbotshme" në të drejtën ndërkombëtare. Ministria e Jashtme ishte e bindur se mendimi i tij do të kishte një influencë në Këshillin e Lidhjes së Kombeve sepse ai, së bashku me dy anëtarët e tjerë të pakicës, ishin shprehur me kompetencë të thellë juridike, duke pasur për objekt thelbin e çështjes që përmbledhej në nenin 5 të Deklaratës shqiptare të vitit 1921. Ndërsa shumica kishte marrë parasysh edhe konsiderata të tjera, duke kapërcyer kështu atributet e veta.

Ai e udhëzonte Lec Kurtin që, në diskutimet që do të kishte me funksionarët e lartë të Sekretarisë së Përgjithshme të Lidhjes së Kombeve, si me anëtarët e Komitetit të Treve që ishte marrë me çështjen e shkollave greke, ashtu dhe me anëtarët që formonin Këshillin e Lidhjes së Kombeve, t'u transmetonte atyre këto mesazhe: pakënaqësinë e qeverisë shqiptare për Vendimin e Gjykatës së Hagës; të përpiqej të evidentonte opinionin e pakicës, duke nënvizuar rëndësinë e kryetarit të

²⁴ *Po aty*.

²⁵ *Po aty*, fl. 278-279, Udhëzime të MPJ – Lec Kurtit, 16 prill 1935.

Gjykatës Cecil Hurst; t'u thuhej se Vendimi i Gjykatës ishte një "avis consultatif" dhe jo një vendim i prerë dhe Këshilli i LK, që ishte një organ politik, nuk duhej ta merrte parasysh këtë vendim në formën e një vendimi gjyqësor të prerë, zbatimi i të cilit "do të krijonte një situatë jo të kënaqshme në Shqipëri dhe qeveria shqiptare do të ndodhej në një gjendje tepër të vështirë përballë indinjatës së opinionit publik, ndërsa qëllimi i Lidhjes së Kombeve ishte që sugjerimet dhe këshillimet e saj të aplikoheshin në një atmosferë qetësie.

Ministri i Jashtëm shqiptar kishte diskutuar në këtë frymë edhe me Ministrin e Anglisë në Shqipëri, i cili i kishte premtuar se do të bënte çka ishte e mundur pranë qeverisë së tij me qëllim që Këshilli i LK të merrte një vendim në formë rekomandimi për qeverinë shqiptare, pa marrë parasysh mendimet e Gjykatës së Hagës²⁶.

Ministri i Jashtëm e udhëzonte përfaqësuesin shqiptar në LK, të përpiqej që Këshilli i LK, në bazë të paragrafit të fundit të Art. 5, t'i drejtonte qeverisë shqiptare një rekomandim me karakter të përgjithshëm, në kuptimin që qeveria shqiptare t'i jepte një zgjidhje praktike çështjes së shkollave greke dhe në përputhje me frymën e Deklaratës së vitit 1921.

Nëse Këshilli do të vepronte kështu, ai mendonte se, me siguri, qeveria greke do të hynte në bisedime me qeverinë shqiptare për të siguruar një "argument mesatar" (zgjidhje të mesme - B.M.). Ai parashikonte që, në çdo rast, për të ruajtur prestigjin e shtetit shqiptar, në marrëveshjen eventuale greko-shqiptare, do t'i kërkohej qeverisë greke çelja e shkollave shqipe në Çamëri. Prandaj ai i kërkonte Lec Kurtit të përpiqej që këto dy çështje të trajtoheshin njëkohësisht²⁷.

Me porosinë e Mbretit Zog, ministri i Jashtëm shqiptar zhvilloi takime me ministrat e Turqisë, Jugosllavisë, Rumanisë, Çekosllovakisë dhe Anglisë. Ai u kërkoi atyre që të përkrahnin pozicionin e Shqipërisë në Këshillin e LK, kur do të diskutohej çështja e shkollave të minoriteteve²⁸. Ai u tha atyre se, meqë mendimi i Gjykatës së Hagës ishte ndarë në shumicë dhe pakicë, shtetëzimi i shkollave nga qeveria shqiptare nuk mund të cilësohej se ishte në kundërshtim me shpirtin e Deklaratës së vitit 1921. Kështu, Këshilli duhej të merrte parasysh edhe mendimin e

²⁶ *AMPJ*, V. 1935, D. 297, fl. 278-279, Udhëzime të MPJ – Lec Kurtit, 16 prill 1935.

²⁷ *Po aty*.

²⁸ *Po aty*, fl. 181, Shënime të ministrit të Jashtëm - dërguar A. Zogut, 24 prill 1935.

pakicës së Gjykatës së Hagës dhe të merrte një vendim me karakter të përgjithshëm, “në formën e një formule transactionelle”, në mënyrë që qeveria shqiptare të lihej e lirë për të aplikuar dispozitat e Deklaratës së vitit 1921, pa cenuar parimin e shtetëzimit. Gjithashtu, meqë pakica shqiptare e Çamërisë i kishte dërguar një peticion Lidhjes së Kombeve për të kërkuar çeljen e shkollave shqipe, Këshilli i LK duhej njëkohësisht t’i bënte rekomandime edhe qeverisë greke. Në rast të kundërt, nëse Këshilli do të komunikonte vendimin e Gjykatës së Hagës në formën e një verdikti, administrata shqiptare do të ndodhej në vështirësi të mëdha për zbatimin e këtij vendimi.

Ministri i Turqisë në Tiranë premtoi pa rezerva se do t’i telegrafonte menjëherë ministrit të Jashtëm, Tefik Ruzhdi Arasit. Ministri jugosllav i çoi një telegram ministrit të Jashtëm, Jevtiç por shfaqti dëshirën që të çelej shkolla serbe në Vrakë. Edhe ministri Rumun premtoi se do t’i telegrafonte Tituleskut që të përdorte influencën e tij në Lidhjen e Kombeve për të arritur në adoptimin e një formule të kënaqshme dhe për mbrojtjen e prestigjit të qeverisë shqiptare. Por, edhe ky shfaqti pakënaqësinë e qeverisë rumune se dy shkollat rumune në prefekturën e Korçës nuk ishin çelur plotësisht dhe sipas premtimeve të Mbretit Zog. Sipas informacioneve që kishte dhënë Ministria e Arsimit, në këto dy shkolla gjuha rumune mësohej disa orë, si gjuhë ndërsa lëndët e tjera zhvilloheshin në gjuhën shqipe. Gjithashtu nxënësit arumunë zhvillonin mësimet së bashku me nxënësit shqiptarë²⁹. Përfaqësuesi çekoslovak premtoi se, do t’i dërgonte një letër të gjatë Beneshit rreth pikëpamjes së qeverisë shqiptare. Ai tha se Beneshi e njihte këtë problem dhe kërkesa shqiptare do të gjente një kuptim dashamirës. Por, edhe ky u ankua për pengesat që u kishte vënë qeveria shqiptare eksporteve çekosllloake dhe për blerjen e duhanit në Shqipëri³⁰.

Përfaqësuesi i Shqipërisë në Gjenevë, Lec Kurti e trajtoi këtë problem edhe me zëvendëssekretarin e Përgjithshëm të LK, de Ascaratte, i cili u përgjigj se ishte e pamundur që Këshilli i LK të mos mbështetej në mendimin e shumicës së Gjykatës së Hagës, siç kishte vepruar gjithmonë. Ai shtoi se “Çështja e pakicës në Shqipëri nuk mund “të abinohet” me çështjen e pakicave në Greqi, pasi kjo e fundit ishte gjithnjë në dorë të Komitetit të Treve, prandaj Këshilli, duke mos qenë i nxitur për t’u marrë

²⁹ *Po aty.*

³⁰ *Po aty.*

me këtë çështje, nuk mund ta trajtonte atë në këtë kohë. Kështu që Këshilli nuk mund t'i bënte rekomandimet njëkohësisht Shqipërisë dhe Greqisë, sepse Greqia ende nuk ishte thirrur përpara tij për t'u mbrojtur dhe justifikuar³¹. Lec Kurti, theksonte se, një veprim i tillë mund të ishte bërë nëse pala shqiptare do t'i kishte paraqitur një peticion Sekretariatit të LK kur Komiteti i të Treve merrej me çështjen e pakicave tona në Paris, por tashmë ky shans ishte humbur. Ai shtonte se atëherë i kishte kërkuar Ministrisë së Jashtme që të ndërmerrej ky veprim por, sugjerimi i tij nuk ishte marrë parasysh³².

Lec Kurti gjithashtu i bëri të ditur zyrtarit të lartë të Lidhjes së Kombeve se pakicat në Shqipëri ishin aq të varfra sa që kurrsesi nuk mund të mbanin shkolla me mjetet e tyre. Prandaj qeveria shqiptare kishte të drejtë që, në të ardhmen, t'ua mbyllte të gjitha shkollat atyre, pasi ato mbaheshin me financime të huaja. Gjithashtu ajo mund të pezullonte shumicën e mësuesve pasi ata, jo vetëm që nuk kishin mbaruar një shkollë normale, por nuk kishin kryer as shkollën e mesme. Këshilli i LK nuk mund t'ia mohonte këto të drejta qeverisë shqiptare. Por qëllimi i qeverisë shqiptare ishte që të ndiqte një politikë sa më liberale ndaj pakicave dhe që të mos i shkaktonte shqetësime Lidhjes së Kombeve për të tilla çështje. Mirëpo, kjo fatkeqësisht do të mbetej thjesht një dëshirë platonike, pasi opinioni shqiptar, në njërën anë, konstatonte sjelljen liberale të qeverisë shqiptare ndaj pakicave dhe, në anën tjetër, po denonconte dhe ishte i frustruar nga trajtimi johuman i pakicave shqiptare në Greqi e në Jugosllavi.

Lec Kurti i kërkonte autorizim Ministrisë së Jashtme që t'u paraqiste gojarisht zyrtarëve të Lidhjes së Kombeve këto propozime: 1) mbajtja e shkollave të pakicave me fonde të qeverisë në formë subvencioni; 2) mësuesit të caktoheshin prej pakicave e të miratoheshin prej qeverisë shqiptare. Ai mendonte se ky mund të ishte një kompromis me reporterin e Lidhjes së Kombeve, në mënyrë që një deklaratë e tillë të pranohej prej Këshillit, pa qenë nevoja që ky të bënte rekomandime. Ai sugjeronte se, për këtë qëllim, duheshin kontaktuar edhe përfaqësuesit e Francës, Anglisë, Italisë dhe Çekosllovakisë në Tiranë, për të ndikuar tek qeveritë e tyre që ato të mbështesnin këtë kompromis.

³¹ *Po aty*, fl. 273-275, Lec Kurti – MPJ, Gjenevë, 26 prill 1935.

³² *Po aty*.

Por, përgjigja e ministrit britanik në Tiranë ishte dekurajuese. Ai informoi ministrin e Jashtëm Shqiptar, Xhaferr Vila se qeveria britanike nuk mund të ndërhynte pranë qeverisë greke për arritjen e një kompromisi pasi, duke ndërhyrë, do t'i njihte njëfarë të drejte Greqisë në punët e brendshme të Shqipërisë dhe ngaqë, si në Gjenevë ashtu edhe në Hagë, dy personalitete të rëndësishëm britanikë kishin përkrahur pikëpamjen shqiptare. Kështu, qeveria britanike nuk mund t'i sugjeronte Athinës një marrëveshje e cila ishte në kundërshtim me pikëpamjet e shprehura të këtyre dy personaliteteve britanike. Ministri britanik theksoi se qeveria e tij vazhdonte të kishte simpati për Shqipërinë, "megjithëse në çështjen e shkollave, qeveria shqiptare nuk kishte vepruar me aftësi. Qeveria britanike e këshillonte qeverinë shqiptare që përfaqësuesi shqiptar në Gjenevë të hynte në kontakt me reporterin e çështjes së shkollave minoritare, me qëllim që, në raportin që do t'i paraqitej Këshillit të LK, të sugjerohej një "modus vivendi", natyrisht duke marrë si bazë mendimin e shumicës së Gjykatës së Hagës. Gjatë këtyre bisedimeve, në rast se do të ishte e nevojshme, edhe përfaqësuesi britanik do të përdorte influencën e tij që të arrihej një marrëveshje e pëlqyeshme³³.

Legata Shqiptare në Londër siguroi botimin e një artikulli të favorshëm për qëndrimin e qeverisë shqiptare në revistën prestigjioze "Near East". Artikulli bënte edhe ndonjë kritikë ndaj qeverisë shqiptare por toni i përgjithshëm i tij ishte në favor të saj. Në të thuhej se shtetëzimi i shkollave nuk kishte qenë një veprim arbitrar dhe nuk drejtohej kundër pakicave. Ai përmendte ankesat e parisë së Çamërisë në Lidhjen e Kombeve për çeljen e shkollave shqipe dhe sugjeronte një zgjidhje të urtë, konkretisht një vendim nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve për negociata miqësore midis qeverisë greke e qeverisë shqiptare³⁴. Legata e Londrës konstatonte se shtypi britanik kishte shkruar pak për këtë problem por, ato pak materiale që ishin botuar, kishin mbështetur qëndrimin e qeverisë shqiptare dhe nuk ishte botuar ndonjë artikull në favor të pikëpamjes greke. Ndryshe kishte ndodhur me shtypin francez, i cili kishte mbështetur qëndrimin e palës greke.

Edhe ministri Rauf Fico njoftonte nga Beogradi se, siç ishte informuar nga zëvendësministri i Jashtëm jugosllav Puriç, qeveria greke

³³ *Po aty*, V. 1935, D. 94, Ministri i Jashtëm Xhaferr Vila – A.Zogut, 30 prill 1935.

³⁴ *Po aty*, D. 297, fl. 289, Legata Shqiptare, Londër – MPJ, 4 maj 1935.

nuk kishte pranuar të bënte ndonjë ndryshim në qëndrimin e saj për çështjen e shkollave³⁵.

Ministri i Shqipërisë në Paris, Eqrem Libohova u takua me përfaqësuesin e Spanjës në Lidhjen e Kombeve, Madariaga, i cili ishte një personalitet me influencë të madhe në Këshillin e Lidhjes. Libohova u përpoq ta bindte atë për nevojën e domosdoshme që kishte Shqipëria të unifikonte ndërgjegjen kombëtare të rinisë, duke laicizuar dhe shtetëzuar shkollat. Ministri shqiptar këmbënguli, duke nënvizuar se Shqipëria, qysh prej krijimit të saj si shtet i lirë, nuk kishte shtypur asnjëherë ndonjë prej pakicave që ndodhen në tokën e saj. Si provë për këtë ai përmendi Deklaratën e vitit 1921, e cila ishte bërë në një kohë kur Shqipëria nuk kishte qenë e detyruar të merrte angazhime ndërkombëtare ndaj pakicave, sidomos për arsyen se asnjëri prej shteteve fqinje, dhe në radhë të parë Greqia, nuk mori as më të voglin angazhim kundrejt pakicës shqiptare në tokën e saj. Më tej Libohova i shpjegoi përfaqësuesit spanjoll se reforma e aplikuar ruante vazhdimësinë e shkollave si në të kaluarën, por me të vetmin ndryshim se këto vareshin nga shteti shqiptar dhe kjo bëhej, jo për të shtypur dhe denacionalizuar pakicat, por vetëm e vetëm për të konsoliduar shtetin dhe për të evituar propagandat e huaja. Mirëpo, për habinë e Libohovës, Madariaga e injoroi këtë argumentim. Ai besonte se qeveria shqiptare kishte suprimuar shkollat greke, duke i zëvendësuar këto me shkolla tërësisht shqipe. Libohova i kërkoi atij të influenconte që Këshilli i LK të mos fajësonte Shqipërinë ose të kërkonte abrogimin e programit të qeverisë shqiptare për pakicat, por të mjaftohej me rekomandime të lehta, që mund të adaptoheshin në dispozitat e reja të Statutit Themeltar, të cilat qeveria shqiptare do t'i respektonte plotësisht.

Më tej, Libohova i tha bashkëbiseduesit spanjoll se, nëse Shqipëria do të detyrohej të abrogonte masat që kishte marrë në fushën e arsimit, natyrisht duhej të hiqte dorë nga i gjithë ideali i saj, i cili ishte unifikimi i ndërgjegjes kombëtare dhe suprimimi i grindjeve dhe i përçarjeve, që ndërhyrja e klerit të besimeve të ndryshme, kishte krijuar prej shumë kohësh midis popullit shqiptar³⁶.

³⁵ *Po aty*, fl. 295, Rauf Fico – MPJ, Beograd, 8 maj 1935.

³⁶ *Po aty*, D. 297, fl. 285, Ministri i Shqipërisë në Paris, Eqrem Libohova – MPJ, 8 maj 1935.

Por, qëndrimi negativ i Madariagës duket se nuk ndryshoi. Madje pas disa ditësh ai shfaqti zemërimin e tij për deklaratën e qeverisë shqiptare, duke e quajtur atë të pasaktë³⁷.

Dilemat e qeverisë shqiptare dhe pakicës greke pas Vendimit të Hagës

Pas Vendimit konsultativ të Gjykatës së Hagës çështja e shkollave grekofone u diskutua nga Këshilli i LK në 20 maj 1935. Këshilli i LK pranoi raportet e dy delegatëve të shteteve të interesuara. Më 23 maj, Këshilli nuk dha një vendim përfundimtar por, vendosi që çështja të shtyhej për në sesionin e shtatorit³⁸.

Kjo shtyrje krijoi pakënaqësi në popullsinë minoritare, e cila ishte e shqetësuar se fëmijët do të humbnin edhe një vit tjetër shkollor. Grindjet midis ekstremistëve dhe të moderuarve në radhët e minoritetit po thelloheshin

Krahu i moderuar mendonte se, edhe sikur Këshilli i LK të merrte një vendim të favorshëm, aplikimi i tij do të ishte në kundërshtim me interesat vitale të vetë minoritetit dhe do të viheshin në rrezik të drejtat që ai gëzonte sepse shqiptaret ishin shumë kryelartë dhe ata do të aplikonin politika shumë të rënda dhe të padurueshme ndaj minoritetit, si p.sh. instalimi i emigrantëve shqiptarë në zonën e minoritetit etj. Ata pohonin se, edhe sikur Lidhja e Kombeve të vendoste që mësuesit të paguheshin nga katundet, meqë kjo shkelte dispozitat konstitucionale të shtetit, minoritarët nuk duhej ta përdornin këtë të drejtë.

Ndërsa pjesa tjetër ekstremiste që përbëhej nga mësuesit dhe propagandistët e konsullatës greke, e këshillonin popullsinë grekofone të bënte durim. Ata propagandonin se, para se të merrej vendimi nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve, të dy qeveritë do t'i jepnin fund kësaj çështjeje në mënyrë miqësore dhe Konsullata greke nuk do të kursehej që të kërkonte një zgjidhje të pëlqyeshme para se të fillonte viti i ri shkollor³⁹.

Gjatë muajit qershor, autoriteteve shqiptare po u vinin informacione se komisioni grekofon i grevës shkollore kishte marrë vendim për çeljen

³⁷ *Po aty*, fl. 293, Lec Kurti – MPJ, Gjenevë, 24 maj 1935.

³⁸ *Demokratia*, “Shkollat grekofone”, 26 maj 1935.

³⁹ *AQSH*, Fondi Kryeministria, V. 1935, D. IV-391, fl.163. Prefektura Gjirokastrë - MPB, 25 maj 1935.

e shkollave në fillim të shtatorit dhe për okupimin e lokaleve të shkollave shtetërore⁴⁰. Në disa katunde, ish mësuesit privatë po jepnin mësimë fshehurazi, duke pranuar në shtëpitë e tyre një sasi nxënësish si vizitorë. Prefektura e Gjirokastrës e kishte konstatuar këtë fenomen por, duke mos dashur që të bënte bujë, e kishte toleruar atë në heshtje⁴¹. Prefektura sugjeroi që, si çdo vit, në përfundim të vitit shkollor, çelësat e shkollave t'u dorëzoheshin pleqësive. Prefekti mendonte se, popullsia grekofone nuk do t'i merrte me përdhuni shkollat⁴².

Gjithashtu prefektura e Gjirokastrës informoi se qeveria greke kishte vendosur që rrogat e mësuesve privatë të siguroheshin nga të ardhurat e testamenteve që kishin lënë shqiptarët ortodoksë në bankat e Greqisë për ndërtimin e mbajtjen e shkollave të fshatrave dhe krahinave të tyre⁴³.

Konsulli grek e falënderoi prefektin e Gjirokastrës për lejimin e shkollave private nga qeveria dhe i deklaroi atij se "Shqipëria, Greqia e Turqia janë tre kombe që mund të kundërbalancojnë sllavizmin në Ballkan. Minoritetet greke dhe shqiptare do të ishin kolonat e miqësisë midis dy shteteve"⁴⁴. Është e tepërt të pohojmë se, autoritetet shqiptare e perceptuan këtë pohim si tallje dhe cinizëm pas gjithë asaj që kishte ndodhur. Ata kishin shumë arsye të ndjeheshin të fyer dhe të prekur rëndë në dinjitetin e tyre dhe të qeverisë që ata përfaqësonin.

Në korrik prefekti i ri i Gjirokastrës i dërgoi një raport të gjatë qeverisë, në të cilin trajtonte gjerësisht problemin e shkollave⁴⁵. Ai mbante qëndrim kritik ndaj vendimit që Ministria e Arsimit kishte marrë në fillim, pra menjëherë pas shtetëzimit të shkollave. Në atë kohë, ajo kishte vendosur që të jepeshin vetëm katër orë mësimi në javë në gjuhën greke, të cilat prefektura i quante të pamjaftueshme. Në këtë raport thuhej se fillimisht, popullsia grekofone e kishte pritur me gjakftohtësi programin e ri të Ministrisë së Arsimit. Por më vonë, kur ajo pa se mësuesit që ishin ngarkuar të jepnin mësimin në gjuhën greke nuk ishin të aftë dhe nuk ishin të diplomuar në shkollat normale të Greqisë dhe kur u konstatuan veprime të tepruara të disa mësuesve të cilët u përpoqën të

⁴⁰ *Po aty*, fl.168, Drejtorja e shkollës Libohovë - MA.

⁴¹ *Po aty*, fl.170, Prefektura Gjirokastrë - MPB, 14 qershor 1935.

⁴² *Po aty*, fl.191, Prefektura Gjirokastrë - MPB, 20 qershor 1935.

⁴³ *Po aty*, F. MPB, V.1935, D.399/a, fl.304. Prefektura Gjirokastrë - MPB, 26 qershor 1935.

⁴⁴ *Po aty*, fl.308. Prefektura Gjirokastrë - MPB, 26 qershor 1935.

⁴⁵ *Po aty*, fl.211-219. Raport i Prefekturës së Gjirokastrës - MPB.

ndalonin nxënësit të flisnin greqisht në shkollë si dhe gabime të tjera, u zgjua fanatizma greke.

Ky ishte vështrimi i ri kritik i këtij raporti. Dhe pasi kemi përshkruar me imtësi zhvillimin e ngjarjeve deri në këtë kohë, mund të themi se kjo ishte analiza më e drejtë për qëndrimet e gabuara që ishin mbajtur ndaj shkollave në zonën e minoritetit, të cilat kishin çuar në intensifikimin e ndërhyrjes së qeverisë greke dhe në radikalizmin e situatës.

Në historinë e marrëdhënive të shtetit shqiptar me minoritetet ky mund të vlerësohet si akti i parë dhe i fundit i qëndrimeve të saj nacionaliste dhe jo tolerante ndaj minoriteteve, i cili ka shpjegimet dhe shkaqet e veta.

Por, së pari duhet të theksojmë dhe të qartësojmë se edhe ky gabim nuk ka të krahasuar me politikat e ashpra, tepër këmbëngulëse, sistematike, të studiuara dhe mbi të gjitha efektive të spastrimit etnik që kishin ndjekur dhe vijonin të ndiqnin shtetet fqinje, në radhë të parë Greqia, e cila reagoi fuqishëm që të zhvleftësonte këtë masë të qeverisë shqiptare. Politika greke ndaj minoritetit shqiptar kishte dimensione krejtësisht të tjera dhe shumë më të rrezikshme dhe cinike. Ajo ishte një politikë e kalkuluar mirë për të dobësuar, thyer dhe pastaj për të realizuar spastrimin etnik dhe asimilimin e shpejtë etnik të pakicës shqiptare, me mjete dhe metoda kriminale. Mjafton vetëm të shqyrtojmë natyrën e problematikës që u diskutua në organizmat ndërkombëtare për të kuptuar dallimin që ekzistonte midis të dy shteteve në qëndrimet ndaj minoriteteve përkatëse.

Masat që mori fillimisht qeveria shqiptare për të pakësuar orët e mësimin në gjuhën greke dhe për disiplinimin e mësimdhënies në këto shkolla u provokuan pikësëpari nga ndërhyrja e qeverisë greke, e cila po e shndërronte mësimdhënien në shkollat minoritare në një fushë të propagandës së saj politike dhe në shkeljen e vazhdueshme të parashikimeve të Deklaratës së vitit 1921 prej fshatrave minoritare. Këto shkolla kishin neglizhuar dhe po i bënin një rezistencë të fortë dhënies së gjuhës shqipe. Pagesat e mësuesve të këtyre shkollave bëheshin në mënyrë të paligjshme nga konsullatat greke dhe qarqet vorio-epirote, duke e sfiduar hapur autoritetin e shtetit shqiptar.

Veçanërisht veprimtaria intensive e organizatave vorio-epirote, të cilat dukej sheshit se kishin përkrahjen dhe nxitjen e Athinës zyrtare, shkaktoi shqetësime të vazhdueshme dhe tension tek autoritetet lokale dhe qendrore shqiptare. Ata vazhdimisht ishin të shqetësuar se këto

qarqe po e keqpërdoronin politikën parimore dhe tolerante të shtetit shqiptar ndaj minoritetit grekofon. Ata e kishin konceptuar minoritetin si një pararojë për të ngjallur helenizmin në gjithë Shqipërinë e Jugut, për të paralizuar institucionet kombëtare shqiptare dhe procesin e konsolidimit të shtetit kombëtar shqiptar. Shembujt ishin të shumtë.

Qeveria shqiptare konstatonte me indinjatë se si politikat e saj miqësore, korrekte dhe tolerante ndaj minoritetit grek nuk ndikuan aspak në një kthesë pozitive të politikës së qeverisë greke dhe as në zbutjen dhe zbehjen e aktiviteteve të organizatave vorio-epirote të cilat, edhe pse kishin kaluar rreth dy dekada nga krijimi i shtetit shqiptar, po dëshmonin se as nuk ishin pajtuar me ekzistencën dhe kufijtë e tij dhe as që do të pajtoheshin me to.

Një ndikim të madh kishte edhe politika e qeverisë greke ndaj minoritetit shqiptar në Greqi. Opinioni publik shqiptar dhe qeveria e tij ishin të acaruar me faktin se qeveria greke i kishte mohuar pakicës shqiptare të gjitha të drejtat e saj. Nga ana tjetër, ajo po ushtronte një presion të fuqishëm dhe të vrazhdë mbi shtetin shqiptar, jo për t'i njohur këto të drejta legjitime pakicës grekofone, pasi këto ajo i kishte të siguruara, por për të zgjeruar dhe fuqizuar helenizmin në Shqipërinë e Jugut dhe për të penguar rritjen dhe konsolidimin e ndërgjegjes dhe institucioneve kombëtare shqiptare, veçanërisht në këtë rajon. Me sa duket ndodhi fenomeni i njohur në Ballkan kur nacionalizmat infektonin njëri-tjetrin dhe frymëzonin veprime dhe politika jo korrekte ndaj pakicave, megjithëse nacionalizmi shqiptar nuk mund të vihet kurrsesi në një plan me atë grek për këtë çështje. Ky ishte vetëm një moment që nuk mund ta zbehte aspak dhe ta zhvleftësonte politikën e përgjithshme dhe të përhershme konstante korrekte dhe me vullnet të mirë që kishte ndjekur qeveria shqiptare ndaj këtij minoriteti dhe të tjerave në përgjithësi.

Mbyllja e shkollave private u bë në të gjithë Shqipërinë dhe ajo mori shkas nga konflikti që po zhvillohej midis qeverisë shqiptare dhe Italisë. Qeveria shqiptare i mbylli shkollat private italiane dhe ato katolike në përpjekje për të goditur ndërhyrjen dhe influencën italiane në Shqipëri. Në këtë kuadër u mbyllën edhe shkollat private të minoritetit grek, të cilat, gjithashtu, siç e përmendëm edhe më lart, i kishin shkaktuar shumë shqetësime shtetit shqiptar.

Si shumë shtete të tjera evropiane edhe shteti shqiptar kishte të drejtë ta drejtonte arsimin publik drejt formimit të një brezi me ndërgjegje dhe ndjenja kombëtare, me besnikërinë dhe dashurinë për atdheun e tij dhe,

mbi të gjitha, të eliminonte faktorët historikë të ndarjeve dhe përçarjeve kombëtare që kishin penguar forcimin e unitetit kombëtar shqiptar. Shkollat e huaja kishin qenë njëri prej këtyre faktorëve përçarës. Madje, Shqipëria kishte më shumë se çdo vend tjetër arsye, të ishte këmbëngulëse dhe e kujdesshme për eliminimin e këtyre faktorëve, pasi historia e saj e kishte provuar më shumë se kudo rrezikun e tyre.

Por, e gjykuar nga pikëpamja politike dhe taktike kjo masë ishte e gabuar, pasi një ndërmarrje e tillë kishte fare pak shanse për sukses. Duket se qeveria shqiptare i kishte kalkuluar gabim limitet e saj në këtë drejtim. Ajo hapi njëherazi një konflikt me disa nga fqinjët e saj të fuqishëm dhe me influencë, duke përfshirë këtu në radhë të parë Italinë pastaj edhe Greqinë. Kuptohet, pavarësisht se deri ku ishte e drejta e saj, ajo ishte në një raport krejt të pabarabartë me kundërshtarët e saj për këtë çështje. Ishte ky raport tërësisht i pabarabartë që përcaktoi edhe dështimin e plotë të Tiranës në lidhje me çështjen e shtetëzimit të shkollave private apo mbylljen e tyre. Vërtet qeverisja e brendshme në Shqipëri, për herë të parë, po ecte në një proces të gjatë pozitiv stabiliteti dhe konsolidimi por, në arenën ndërkombëtare pozitat e saj nuk ishin në këtë proporcion.

Siç do ta parashtrojmë më tej, qeveria shqiptare jo vetëm u detyrua nga një organizëm ndërkombëtar, siç ishte Lidhja e Kombeve, të tërhiqej nga qëndrimi i saj por, ajo do të bënte lëshime të tjera në çështje që nuk kishin të bënin me minoritetet por, me ngadalësimin dhe shmangien nga procesi i konsolidimit dhe afirmimit të disa institucioneve kombëtare. Madje, ajo u ndje e kërcënuar se, tashmë, grekët dhe italianët, me mbështetjen edhe të disa Fuqive të tjera, mund të shkonin aq larg sa të kërcënonin me shpërbërje shtetin shqiptar. Ndofta ky episod i pakëndshëm ishte një nga kalkulimet e pakta të gabuara të Mbretit Zog në politikën e tij të brendshme dhe atë të jashtme.

Administrata shtetërore nuk ishte e aftë të ndalonte shkeljet ligjore si pagesat e paligjshme të mësuesve të shkollave private nga jashtë vendit të cilat ndaloheshin në të gjitha traktatet e minoriteteve; propagandën politike që bënin ata në zbatim të porosive të organizatave vorio-epirote dhe, madje, nuk mundi as që t'i dokumentonte këto shkelje; nuk mundi të impononte dhënien e gjuhës shqipe dhe zbatimin e gjithë standardeve të tjera për shkollat minoritare që kërkonin traktatet e minoriteteve dhe Deklarata shqiptare e 2 tetorit 1921; nuk dënoi me korrektesë dhe me kompetencë, në mënyrën dhe masën që e përcaktonte ligji, këto shkelje. Kështu, ajo nuk ndoqi rrugën më të drejtë dhe efektive, e cila që nuk

mund të atakohej nga asnjë organizëm i huaj, nuk ndoqi këtë rrugë e cila i shërbente edhe zhvillimit normal të marrëdhënieve me minoritetin, por bëri një hap të gabuar, duke marrë një masë që i krijoi mundësi qeverisë greke ta shtronte çështjen në Lidhjen e Kombeve dhe të siguronte ndërhyrjen e saj për të anuluar masat kushtetuese të qeverisë shqiptare.

Gjithsesi, udhëzimet e prera që dha Ministria e Arsimit kur u bë shtetëzimi i shkollave të minoritetit, që në shkollat shtetërore të gjitha lëndët të zhvilloheshin në gjuhën greke dhe përpjekjet serioze që bëri për rritjen e nivelit të mësimdhënies në këto shkolla, dëshmonin se qeveria shqiptare nuk kishte pasur si qëllim të fillonte një proces asimilimi të minoritetit grek apo të dobësimit të identitetit të tij por, kishte synuar vetëm frenimin e propagandës dhe ndërhyrjes greke në shkollat minoritare dhe përgatitjen e brezit të ri të minoritetit me idenë dhe ndjenjën e të qenit qytetar shqiptar, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ndaj shtetit të cilit i përkiste.

Edhe raporti i prefektit të ri të Gjirokastrës, nënvizonte se, shkaktarët kryesorë të lëvizjes për shkollat private minoritare kishin qenë mësuesit privatë, të cilët kishin zhvilluar një propagandë të fuqishme, si dhe konsullatat greke që kishin intensifikuar propagandën dhe aktivitetin e tyre.

Fillimisht kryepleqtë e katundeve grekofone nuk kishin guxuar të ankoheshin hapur tek qeveria shqiptare. Vetëm, kryeplaku i katundit Dervişan ishte bindur me vështirësi nga sekretari i Konsullatës greke, Jorgji Papadhopulli, që t'i dërgonte një telegram Mbretit Zog, në emër të popullit të këtij katundi. Ky telegram ishte ndaluar nga autoritetet lokale dhe kryeplaku u mbajt në vërejtje për 20 ditë në Gjirokastrë prej prefektit të atëhershëm. Në raport ky veprim cilësohej si një gabim shumë i madh, pasi lehtësoi propagandën e Konsullatës greke e cila, diku me frikësime, diku me të holla, arriti të organizonte katundet grekofone që t'i drejtoheshin Këshillit të Lidhjes së Kombeve me një ankesë, e cila u organizua dhe u mor nga konsujt grekë dhe më pas iu dorëzua përfaqësuesit të Greqisë në Gjenevë.

Prefektura informonte se, kur kishin filluar lëvizjet e vorio-epirotëve dhe regjistrimi i vullnetarëve në Greqi, konsullatat greke në Shqipëri ishin përpjekur që të krijonin ndonjë incident të përgjakshëm, në mënyrë që të nxisnin bandat vorio-epirote përtej kufirit të hynin brenda kufirit shqiptar. Por, kjo ishte evituar nga masat e marra dhe nga qëndrimi i

kujdesshëm i Prefekturës e cila nuk kishte lejuar që të ndodhte asnjë lloj incidenti.

Sipas raportit, tashmë shumica e popullsisë grekofone besonte se, në bazë të Vendimit të Gjykatës së Hagës dhe sidomos pas deklaratave të Mehdi Frashërit në Këshillin e LK, qeveria shqiptare do të lejonte mësimin e gjuhës greke me mësues privatë si dhe më parë. Konsullata greke po përpiqej ta përforconte këtë bindje, duke propaganduar se përfaqësuesi i Shqipërisë në Athinë kishte njoftuar zyrtarisht Ministrinë e Jashtme të Greqisë se qeveria shqiptare do të aplikonte me përpikmëri Vendimin e Hagës, ashtu siç kishte deklaruar edhe Mehdi Frashëri në Këshillin e LK.

Por, një pjesë tjetër e grekofonëve ende nuk besonte se qeveria shqiptare do të lejonte mësimin e gjuhës greke me mësues privatë, duke ditur se këta mësues paguheshin prej qeverisë greke. Ata e konsideronin si të dëmshme këmbënguljen e mëtejshme për mësues privatë, pasi trembeshin se qeveria shqiptare do të merrte masa të rrepta si instalim emigrantësh në zonën e minoritetit etj. Kështu mendonin edhe një pjesë e parisë së katundeve grekofone, të cilët, kishin parasysh humbjet që kishin pësuar fëmijët nga greva e vitit të kaluar. Ata, pa marrë parasysh se në shtator çështja do të zgjidhej në përputhje me kërkesën e tyre, donin t'i dërgonin fëmijët në shkolla edhe me mësues zyrtarë. Disa po flisnin hapur se, meqë qeveria shqiptare kishte lejuar mësimin e gjuhës greke në shkolla, qëllimi ishte arritur dhe tashmë ata nuk e pëlqenin këmbënguljen për mësues privatë. Kjo pjesë e opinionit minoritar ishte më racionale dhe nuk dëshironte që minoriteti të futej në kurthin e përplasjeve politike midis qeverive greke dhe shqiptare për çështjen e shkollave private. Pra, opinionin publik në katundet grekofone ishte i përçarë dhe po të vazhdonte të zgjatej çështja edhe pak, pasi të fillonte viti shkollor, do të vijonte dërgimi i fëmijëve në shkolla.

Edhe prefekti i ri i Gjirokastrës e kundërshtonte pranimin e mësuesve privatë, sepse kjo ishte në kundërshtim me të drejtat konstitucionale dhe me Kodin Civil, sipas të cilit një nënshtetas shqiptar që merrte rroga nga një shtet i huaj, humbiste nënshtetësinë shqiptare dhe qeveria shqiptare kishte mundësi ta dëbonte atë jashtë shtetit si person i padëshirueshëm.

Sipas prefekturës, tashmë pas mësimit të gjitha lëndëve në gjuhën greke, çështja e shkollave grekofone duhej të konsiderohej e zgjidhur. Madje, Ministria e Arsimit tashmë kishte hequr nga këto shkolla edhe mësimin e gjuhës shqipe, të cilën nuk kishte katund grekofon që të mos

dëshironte të mësohej. Kjo dëshirë e grekofonëve për mësimin e gjuhës shqipe, u ishte parashtruar në çdo rast autoriteteve zyrtare shqiptare, sepse interesat e tyre e kërkonin këtë gjë. Në fakt, ky konstatim i prefekturës ishte një element i ri në qëndrimin e minoritetit i cili deri në këtë kohë, ndonëse nuk e kishte kundërshtuar hapur mësimin e gjuhës shqipe, e kishte neglizhuar ose nuk kishte shfaqur ndonjë dëshirë të qartë për mësimin e saj. Vendimi i Ministrisë së Arsimit për mosdhënien e gjuhës shqipe në shkollat minoritare, edhe pse i përkohshëm dhe i diktuar nga rrethanat e krijuara, ishte një gabim tjetër i saj që dëshmonte për panik dhe mungesë kompetence për ta përballuar situatën e krijuar.

Prefektura bënte vërejtje se kërkesa për mësuesit privatë kishte karakter dhe motive politike dhe se ajo nuk ishte trajtuar drejt në Lidhjen e Kombeve. Ajo kërkonte prej qeverisë të arrihej një marrëveshje me qeverinë greke, e cila të hiqte dorë nga caktimi i mësuesve privatë. Nëse Ministria e Arsimit nuk kishte gjetur ndonjë mënyrë që çështja të zgjidhej pa prekur interesat e shtetit, prefektura sugjeronte që zgjidhja të zgjatej edhe pak dhe të merreshin disa masa për të përçarë lidhjen e grekofonëve që kishin krijuar konsullatat greke të Gjirokastrës e të Sarandës për bojkotimin e shkollave.

Prefektura e Gjirokastrës shpjegonte se popullsia grekofone e atij qarku ndahej në tre kategori: 1) Katundet e Dropullit që vareshin nga komuna e qendrës Gjirokastër dhe nga komuna e Libohovës dhe Jergucatit; 2) Kategorinë e dytë e formonin katundet e komunës së Pogonit; 3) Kategorinë e tretë e formonin disa nga katundet e Delvinës, Konispolit dhe të Sarandës, shumica e banorëve të cilëve ishin bujq proletarë dhe punonin në çifligjet e pronarëve shqiptarë. Në këtë grup vetëm banorët e pak katundeve nuk ishin bujq, si Dhrovjani, Leshnica e ndonjë tjetër.

Katundet e Dropullit ishin nën influencën e Konsullatës greke pasi ishin afër qytetit dhe propaganda greke tek ta zhvillohej me lehtësi me anën e tregtarëve grekofonë që vepronin në Gjirokastër. Por, ndonëse popullsia grekofone e Dropullit cilësohej si më fanatikja për ndjenjat greke, një pjesë e madhe e saj ishin bujq qiramarrës në pronat e shqiptarëve. Gjithashtu, një luadh i njohur me emrin "Çairi i Madh" ishte tokë shtetërore, gjë që e bënte të mundur instalimin e emigrantëve shqiptarë në këto zona. Prefektura e propozonte këtë veprim, si një mjet presioni për të "tronditur lidhjen e grekofonëve për bojkotimin e shkollave".

Në kategorinë e dytë që përbëhej nga banorët e Komunës së Pogonit, kishte disa katunde si Hllomo etj., që në këtë moment kishin vendosur t'i dërgonin fëmijët në shkolla në shtator edhe nëse mësuesit nuk do të ishin privatë. Këto katunde edhe në vitin e kaluar, me gjithë propagandën dhe presionet që kishte bërë Konsullata greke, kishin dërguar rregullisht fëmijët në shkolla, në një kohë kur në katundet e tjera greva vazhdonte me vendosmëri.

Prefektura mendonte se, nëse do të detyrohej të tërhiqej nga greva, Dr. Këçati nga Poliçani, i cili ishte njëri ndër krerët më me influencë të asaj krahine, në të gjithë katundet e Pogonit, greva do të pushonte. Për këtë qëllim ajo sugjeronte t'u jepej një leje e detyrueshme dhe e gjatë dy pjesëtarëve të fisit Vavako që punonin në Ministrinë e Ekonomisë Kombëtare. Kështu, Dr. Këçati do të tërhiqej nga greva pasi ai ishte dhëndri i kësaj familje. Gjithashtu Vavakove u duhej lënë të kuptonin se vazhdimi i grevës në katundet e Pogonit do të shkaktonte, jo vetëm pushimin e tyre nga puna por edhe largimin e gjithë nëpunësve grekofonë. Në këtë mënyrë do të përçaheshin grevistët në komunën e Pogonit.

Në këtë periudhë ishin nëpunës të shtetit shqiptar këto minoritarë: 5 grekofonë në Ministrinë e Drejtësisë (sekretar gjyqi, prokurorë e noterë); 3 grekofonë në Ministrinë e Financave (sekretarë dhe tagrambledhës); 2 grekofonë në Ministrinë e Ekonomisë Kombëtare (Drejtori i Bujqësisë dhe Drejtori i Laboratorit); 7 veta në Ministrinë e Brendshme (mjekë); 1 kapter në Komandën e Mbrojtjes Kombëtare, 1 kryepunëtor në Ministrinë e Punëve Botore dhe 41 mësues në Ministrinë e Arsimit⁴⁶.

Kategoria e tretë që ishin bujq në çifligjet e pronarëve shqiptarë ishte në një pozitë edhe më të dobët. Po të porositeshin pronarët e çifligjeve që t'u kërkonin bujqve të tyre të mos merrnin pjesë në grevën e shkollave, padyshim, situata në këto fshatra do të ndryshonte. Pronarët e çifligjeve këtë porosi do ta prisnin me gëzim, pasi do të ishte një rast i mirë për ta që, me ndihmën e qeverisë, të dëbonin ata bujq që nuk i donin në çifligjet e tyre.

Këto propozime të prefektit të ri të Gjirokastrës shprehnin tensionin që kishte krijuar Vendimi i Gjykatës së Hagës tek autoritetet lokale shqiptare. Në këtë gjendje nuk është e vështirë të kuptohet se disa prej

⁴⁶ *Po aty*, Fondi MPB, V. 1935, D. 318. Lista e grekofonëve që ishin nëpunës të shtetit.

tyre ishin me frymëzim nacionalist dhe e thellonin krizën dhe konfliktin. Për këtë arsye kjo pjesë e propozimeve nuk u pranua nga qeveria.

Disa nga grekofonët kishin propozuar si zgjidhje kompromisi që shkollat të ishin nën administrimin e mësuesit të shtetit, i cili të jepte mësimet shqip por, njëkohësisht, në këto shkolla të jepte mësim edhe një mësues privat për greqishten. Prefektura mendonte se ky propozim meritonte të shqyrtohej.

Sipas informatave që kishte prefektura, modifikimi i programit të shkollave greke dhe lejimi i mësimit tërësisht në gjuhën greke ishin konsideruar të mjaftueshme prej popullsisë grekofone. Por çështjen tashmë e kishte marrë në dorë qeveria greke, e cila këmbëngulte që mësuesit të ishin privatë. Kështu grekofonët nuk guxonin të shfaqnin hapur pëlqimin e tyre për zgjidhjen që i kishte dhënë kësaj çështjeje qeveria shqiptare. Prandaj prefekti i Gjirokastrës mendonte se koha ishte e favorshme për të bërë një sondazh që të arrihej një marrëveshje miqësore, e cila ta zgjidhte çështjen në mënyrë të pëlqyeshme për qeverinë shqiptare⁴⁷.

Megjithëse politika arsimore e qeverisë ishte goditur rëndë, ajo vijonte të mbante një qëndrim të moderuar. Kështu, një shembull i tillë ishte falja nga Mbreti Zog e Grigor Licit nga Jergucati, që kishte qenë kryetar i lëvizjes së grekofonëve dhe para 2-3 vjetëve ishte dënuar me vdekje nga Gjyqi Politik. Megjithëkëtë, sapo u fal, ai vazhdoi aktivitetin e tij të mëparshëm⁴⁸.

Edhe gjatë muajit gusht, prefekti i Gjirokastrës, Siri Leskoviku, i kërkoi Ministrisë së Brendshme që në shkollat grekofone të aplikohet programi i vitit të kaluar për mësimin në greqisht me mësues të shtetit të cilët, mundësisht, të ishin grekofonë që të kishin mbaruar normalet greke. Ai propozonte që shkollat të hapeshin shpejt dhe mësuesit të paraqiteshin në detyrë me qëllim që t'u priteshin grekëve shpresat për emërimin e mësuesve privatë⁴⁹.

Në këtë kohë përfaqësuesit e disa prej katundeve të Dropullit e diskutuan çështjen e shkollave edhe një herë me konsullin grek, të cilit i kujtuan edhe masat që mund të merrte qeveria shqiptare në qoftë se do të

⁴⁷ *Po aty*, D.399/a, fl.211-219. Raport i Prefekturës së Gjirokastrës - MPB.

⁴⁸ *Po aty*, fl.210. Komanda e Truprojës së Kufirit Tiranë - Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, 22 korrik 1935.

⁴⁹ *Po aty*, fl.230. Prefekti i Gjirokastrës, Siri - MPB, 8 gusht 1935.

këmbëngulej për mësuesit privatë, gjë që do të dëmtonte shumë interesat e katundeve grekofone. Konsulli i këshilloi që ata të lidhnin kontrata me ata mësues që dëshironin, me konditë që mësuesit të mos ishin të huaj por prej atyre që kishte emëruar qeveria shqiptare për mësimin e gjuhës greke vitin e kaluar. Qëllimi i këtij propozimi ishte që mësuesit, të cilët do të paguheshin prej shtetit shqiptar, të merrnin edhe një rrogë nga Konsullata greke për t'i shërbyer propagandës së saj si dhe më parë⁵⁰.

Disa ditë më vonë prefekturës i erdhën informata se konsulli grek kishte udhëzuar çdo katund grekofon të zgjidhte një këshill për hapjen e shkollës, të hapeshin shkollat më 25 gusht dhe pastaj të lajmëroheshin autoritetet shtetërore⁵¹.

Me rihapjen e shkollave private minoritare, tensioni midis dy vendeve u ul, por problematika dhe debatet shqiptaro-greke nuk u shuan. Greqia do të përfitonte prej kësaj fitoreje duke shtuar presionin për përhapjen e helenizmit në Shqipërinë e Jugut. Ndërsa qeveria shqiptare u përpoq që të mbronte institucionet kombëtare dhe rezultatet që kishte arritur në sendërtimin e tyre.

Me rihapjen e shkollave private minoritare, tensioni midis dy vendeve u ul, por problematika dhe debatet shqiptaro-greke nuk u shuan. Greqia do të përfitonte prej kësaj fitoreje duke shtuar presionin për përhapjen e helenizmit në Shqipërinë e Jugut. Ndërsa qeveria shqiptare u përpoq që të mbronte institucionet kombëtare dhe rezultatet që kishte arritur në sendërtimin e tyre.

S u m m a r y

THE ALBANIAN-GREEK RELATIONS AFTER THE HAGUE COURT DECISION (APRIL-AUGUST 1935)

The Hague Court advisory opinion on the issue of the Greek minority private schools caused to a large extent dissatisfaction in public opinion and in official circles in Albania. Meanwhile, in Greece this opinion was enthusiastically welcomed. However, certain groupings in the Greek press were

⁵⁰ *Po aty*, fl.241. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 10 gusht 1935.

⁵¹ *Po aty*, D.399/a, fl.257. Prefektura e Gjirokastrës - MPB, 19 gusht 1935.

skeptic about the willingness of the Albanian government to follow this opinion of the Court.

On the other hand, although the Albanian press had been dissatisfied, it maintained its equilibrium. The Albanian government tried to protect its reputation pointing out that the opinion of the Court had not been unanimous, and that the minority of three members, among which the prominent British lawyer Cecil Hurst, had justified the closing of the Greek minority private schools by the Albanian government.

Meanwhile, certain Greek nationalistic circles had become so exited that they started to incite the Greek minority in Albania to participate in the elections for the Greek Assembly.

Nonetheless, the Albanian government tried to make the Greeks recognize and respect the rights of the Albanian minority in Greece, too. It also tried to influence the Council of the League of Nations to issue a general recommendation that would suggest the Greek government to start negotiations and come to an agreement with the Albanian officials.

In order to achieve this aim, representatives of the Albanian government met with the ministers of Turkey, Romania, Czechoslovakia and Britain. These countries were asked to support in the League's Council the above mentioned Albanian viewpoint. Several of these countries, mainly the Balkan ones, used this opportunity to lay other demands and claims towards Albania. The British minister in Tirana disagreed to give his government's support in the League's Council. However, he negotiated that the opinion of the Court be followed by the Albanian government as a sign of 'good will'.

The Albanian government fully obeyed to the Hague's opinion. Afterwards, the tension between Albania and Greece started to decrease, but the issues and arguments between the two countries continued. Greece would use this chance to intensify its attempts and increase its pressure in order to spread Hellenism in Southern Albania. Nevertheless, the Albanian government tried to protect its national institutions and to consolidate its national achievements.

